

V E N D I M
Nr.563 datë 9.10.1995

PËR APLIKIMIN E PUNËVE PUBLIKE

Në bazë të ligjit nr.7983, datë 17.5.1995 “Për punët publike”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Organet e pushtetit lokal në projektbuxhetin për vitin pasardhës parashikojnë objektet e punëve publike që duan të kryejnë dhe fondet që u nevojiten, shoqëruar me projektin dhe preventivin përkatës dhe paraqitin një kopje në Ministrinë e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë.

2. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë ka për detyrë:

a) Të studiojë projektet e paraqitura për aplikim nga organet e pushtetit lokal.

b) Pasi merr edhe mendimin e sekretarit të shtetit për Pushtetin Lokal vendos për projektin fitues sipas të cilit do të realizohen punët publike.

c) Të kontrollojë zbatimin e projektit nga organet e pushtetit lokal.

3. Në vlerësimin dhe planifikimin e punëve publike të kihen parasysh:

- Shkalla e papunësisë (favorizohen zonat me përqindje më të lartë papunësie).

- Niveli i zhvillimit të zonës ku do të financohet.

- Lloji i punëve që do të kryhen (favorizohen punimet e infrastrukturës që nxisin zhvillimin e zonës).

- Kostoja e projektit (favorizohen projektet me kosto më të ulët).

4. Financimi i projektit përballohet nga:

a) Fondet e ndihmës ekonomike vetëm për shpenzime për paga deri në nivelin e ndihmës ekonomike.

b) Burime të brendshme të buxhetit lokal.

c) Fondet shtetërore për investime

ç) Financime nga organizatat joqeveritare të vendit ose të huaja.

5. Këto kategori punimesh organizohen e drejtohen nga bashkia ose komuna pa zhvilluar tender me njësitë ekonomike që kanë në varësi ose duke krijuar njësi ekonomike të reja deri në realizimin e çdo projekti.

Mënyra e organizimit, struktura e personelit drejtues të këtyre punimeve dhe pagat caktohen nga këshilli i bashkisë ose komunës në përputhje me pagat e ndërmarrjeve ose institucioneve analoge.

6. Fondet e miratuara për financimin e projektit që përfshihen në fondet e ndihmës ekonomike dhe në fondet shtetërore për investime nuk lejohet të përdoren jashtë destinacionit të caktuar. Fondet e papërdorura rishpërndahen nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë dhe sekretari i shtetit për Pushtetin Lokal.

7. Fuqia punëtore caktohet nga kryetari i bashkisë ose komunës nga pjesëtarët e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, si rregull, 1 për çdo familje duke filluar nga familjet që marrin ndihmë të plotë e mandej në ato që marrin ndihmë të pjesshme. Personat nën 18 vjeç dhe mbi 45 vjeç dhe ata me arsim të lartë nuk vendosen në mënyrë të detyruar por vetëm nëse deklarohen vetë vullnetarisht.

8. Kryetari i bashkisë ose i komunës ose personi i autorizuar zyrtarisht prej tij hartonë kontratë me çdo punëtor që merr në punë ku përcaktohet afati i marrjes në punë, orari i punës, paga për punën e kryer si dhe kontributet për sigurimet shoqërore.

9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë dhe ekretari i shtetit për Pushtetin Lokal të nxjerrin udhëzimin përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi